



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3677 Prot

Lezhë, më 21.03.2025

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore", neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja "a" dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, i ndryshuar, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e enjte, në datën 27.03.2025, në orën 11:00, në sallën e Këshillit Bashkiak (në Pallatin e Kulturës Lezhë), me këtë**

REND DITE:

1. Projekt-Vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-28 Shkurt 2025"
2. Projekt-Vendim "Për një shtesë në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 "Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025" dhe detajim e përdorim i fondit të akorduar nga BE"
3. Projekt-Vendim "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 "Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025", detajimi dhe përdorimi i fondeve të trashëguara nga viti 2024 dhe i fondit për ndërhyrjet parandaluese të vitit 2025"
4. Projekt-Vendim "Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2026-2028 (Faza e Parë) të Bashkisë Lezhë"
5. Projekt-Vendim "Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qerasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej"
6. Raport për punën/veprimtarinë e Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2024
7. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Strehimit	E mërkurë	26.03.2025	10:00
2	Komisioni i Sigurisë Publike dhe Emergjencave Civile	E mërkurë	26.03.2025	10:15
3	Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik	E mërkurë	26.03.2025	10:30

